

**ISSUES OF COMPLEXITY AND RECEPTION IN THE NOVEL “GJIN
BARDHELA - STONE THIRST” BY ANTON NIKA BERISHA**
ÇËSHTJE TË KOMPLEKSITETIT DHE TË RECEPTIMIT NË
ROMANIN “GJIN BARDHELA-ETJA E GURËZUAR” TË ANTON
NIKË BERISHËS

Arsim HALILI

Përmbledhje

Romani “Gjin Bardhela i arbresh – Etja gurëzuar” të Anton Nikë Berishës shënon një risi në prozën shqipe për faktin që dëshmon ide dhe shtresime të mëvetësishme të rrëfimit poetik, po njëherit dëshmon veçanti në trajtimin e personazheve e të psikologjisë së tyre. Legjenda shqiptare, po aq edhe realiteti shqiptar, universalizohen dhe krijojnë një korrelacion që ruajnë etno-psikologjinë, për të dhënë një vepër mjaft komplekse dhe komplekse. Pra, përftohet një sfond për veprimin e personazheve, por edhe pasqyrë përmes së cilës autori gjurmon thellë në skutat e psikes njerëzore, për të pasqyruar tundimet, po dhe gjakimet shpirtërore, edhe brenda vetmisë së personazhit.

Objekt vështrimi i kësaj trajtese është zbrëthimi i elementeve thelbësorë të botës poetike e të personazheve, sidomos të personazhit kryesor Gjin Bardhelës; i zbulimi i kufijve të individit përballë kolektivitetit si dhe veçantitë e rrëfimit dhe teknikat të tjera. Duke qenë se kjo vepër si shtjellim tekstor është e ndërlikuar, natyrisht se kërkon një lexim të përqendruar dhe një njohe të çështjeve të letërsisë. Përmes metodës psikanalitike të studimit të tekstit letrar, do të synohet gjurmimi në psikologjinë e personazheve dhe të faktorëve që determinojnë veprimet e tyre në momente dhe rrethana të caktuara. Njohja përmes identitetit të personazhit kryesor, synohet njohja e një komunitet të gjerë të shtegtuar shekuj më parë, aty ku sot e kanë atdheun e tyre, por edhe pas kaq kohësh nuk e kanë harruar atdheun e të parëve.

Fjalët kyçe: *Kompleksitet, receptim, Gjin Bardhela, roman, Anton Nikë Berisha.*

Rreth veprimtarisë letrare dhe shkencore të Prof. dr. Anton Nikë Berishës

Kur flitet e shkruhet për veprimtarinë e Anton Nikë Berishës, duhet më shumë vend e kohë sesa kërkon një kumtesë. Emrin e tij e gjen brenda dhe jashtë etnikumit shqiptar, këtu e mbi pesë dekada. Figura e tij nuk mund të ndiqet vetëm në një fushë të letërsisë, sepse si i tillë do të ishte e paplotë. Mund të thuhet si mik në komunikim gjen marrëveshje, shkaku i mirësjelljes së tij, pavarësisht moshën dhe profesionin që ke. Kur kemi të bëjmë me letërsinë marrëveshja mund të gjendet vetëm nëse ke njohje në shkallë të lartë të kësaj fushe. Fundja edhe kur polemizon sjell faktet që doemos do t’i nënshtroresh mendimit të së vërtetës për atë që e pohon.

Ndriçimi i shumë çështjeve teorike letrare dhe jo vetëm të tilla (student në Universitetin e Zagrebit, ku dëgjoi ligjërata nga profesorë e studiues të shquar kroatë), fundja duke qenë edhe student i prof. Anton Çettës, ai pa dyshim se ndjek rrugën e profesorit të tij në fushën e letërsisë gojore me disa nga botimet e rëndësishme, të cilat sot janë objekt studimi i kësaj fushe nga student e studiues, të rinj e të moshuar. Njohja me kulturat e vjetra dhe të reja të popujve të ndryshëm dhe kërkimet e tij studimore, ka bërë që sot lexuesit t'i kenë veprat e rralla.

Po përmend vetëm dy prej yre të shqipëruar “Epin e Gilgamesht” dhe nga letërsia biblike “Psalmet” e së fundi me një studim të qartësuar mbi kodet e Poetikës së Aristotelit. Emri i Anton Nikë Berishës është po aq i pranishëm edhe në letërsinë për fëmijë, duke shkruar vepra artistike edhe për këtë moshë, madje të pritura mirë nga lexuesit e vegjël e herë duke shkruar studime për këtë pjesë të letërsisë që është jo më pak e rëndësishme, madje mjaft komplekse, për rrethanat në të cilat krijohet ajo.

Qasja e tij për të ndriçuar figura të rëndësishme të veçantë për njerëz të cilët i tejkaluan kufijtë e hapësirës gjeografike shqiptare, pa dyshim që e bënë këtë studiues të thellohet në studimet e tij po aq komplekse dhe serioze, mbi disa figura tani më të njohura siç është Buzuku, Budi, Fishta, Martin Camaj, Nëna Tereze etj. Si pedagog i përkushtuar universitar për disa vjet përtej detit, në Italinë fqinje, në Universitetin e Kalabisë dhe në universitete të tjera, ai nuk u kënaq vetëm me punën pranë katedrës universitare, pa dyshim se bëri një punë me shumë përkushtim, por në fushë veprimtarinë e tij krijuese, nuk do të krijonte komoditetin e studiuesit dhe profesorit nëse nuk do të sillte një vepër mjaft voluminoze për letërsinë e krijuar ndër shekuj të atyre bijve e bijave të gjakut tonë, siç janë arbëreshët në Italinë.

Portretin e Anton Nikë Berishës nuk do ta kishim të plotë nëse, përveç studimeve për letërsi, nuk do të krijonte edhe vetë letërsi. Në këtë rrafsh kushdo që lexon letërsinë artistike Berishës, do ta kuptojë se nuk është autor i klisheve, sa për të plotësuar faqe libri, me një epilog të zbrazët në kuptim artistik dhe estetik. Ndonëse herë - herë e kultivon edhe poezinë, por duket se dashuria qëndron te proza e gjatë dhe këtë dashuri të madhe e plotëson me aq kode poetike brenda prozës, që thjesht lexuesi i veprës së tij do të duhej ta lexojë jo sa për t'u prehur, por edhe për t'u futur më thellë në nëntekstin e asaj, në atë që shkruan mes rreshtash.

Se letërsia e tij i ka nxitur e ngacmuar të tjerët të flasin dhe shkruajnë për veprat e tij, kjo nuk do dyshim. Se letërsia e tij i ka bërë të mendojnë dhe t'i japin mendimet dhe vlerësimet e tyre rreth krijimtarisë letrare të tij, mjafton të shihet se sa e gjerë është bibliografia për veprat e tij në tërësi dhe për ndonjërin nga veprat e veçanta. Pa dyshim se njëra nga veprat që jo pak studiues seriozë dhe lexues të tij të pasionuar të shprehin mendimet e tyre është vepra, e cila nuk është voluminoze. Ajo që e ka bërë ta rritë volumin është arti i saj që e cilëson fund e krye; janë një varg punimesh kushtuar veprës nga studiues shqiptarë dhe të hua, - romani Gjini Bardhela i arbresh - Etje e gurëzuar (2002). Do të mundohem që në këtë kumtesë të sjellë disa mendime e vlerësime për këtë vepër poetike mjaft komplekse dhe mundësinë e vënies së saj në komunikim me lexuesin tanë dhe të juaj.

Hyrje

Kur flitet për praninë e letërsisë në qarqe tjera ndërkombëtare, nuk ka dyshim se në radhë të parë këtë çështje e lidhim kryesisht me emra të letërsisë që tani më e kanë krijuar identitetin e tyre kombëtar. Natyrisht prania dhe pranimi i një letërsie nga një gjuhë tek tjetra nuk mund të paramendohet pa një përkthimi cilësor, qoftë në mënyrë institucionale, qoftë individuale. Ai mjaftojnë këto dy çështje sigurisht se jo. Fundja e gjithë kjo kornizë për të depërtuar letërsia e huaj, pa diskutim është edhe pranimi nga ana e lexuesit për atë që i ofrohet në duar të tij. Nëse flasim për letërsinë shqipe, mund të thuhet se secila periudhë letrare i ka pas shkrimtarët të cilët ose kanë përkthyer nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe, por edhe anasjelltas.

Problematikat e marrëdhënieve të letërsisë me botën tjetër përfshijnë një varg aspektesh, të brendshme dhe të jashtme. Më i rëndësishëm se njohja e hartës së përkthimeve të letërsisë shqiptare, është diskutimi shkencor mbi specifikat e kësaj marrëdhënieje. Origjinalja, pra letërsia jonë, është poetika e parë, që krijon një raport të veçantë me poetikën e ligjërimit letrar tjetër. Prandaj kjo temë meriton vëmendje të posaçme, si nga studiuesit, përkthyesit më të afirmuar, por, po aq edhe nga institucionet shtetërore, përkatëse.

Duhet theksuar se për çështjen e receptimit të letërsisë nga lexuesi i huaj, mund të ngritën shumë çështje për diskutim:

A është gjuha referenca kryesore, për pranimin e një letërsie të huaj?

Konsideroj se kërkesë bazike, madje me shumë përgjegjësi është gjuha jo vetëm si mjet komunikimi letrar, por sa arrin, përkthyesi ta krijoj ekujvalencën mes dy gjuhëve respektive: vepër orgjinal - vepër e përkthyer. Çështje tjetër jo më pak e rëndësishme relacionet mes autorit dhe përkthyesit, në këtë rast kemi përkthyes edhe të indetiteti të njëjtë kombëtar me autorin dhe përkthyes i një origjine tjetër e që me ose pa dashje mes autorit dhe përkthyesit krijohet një lloj dualizmi autorial i veprës. Herë pas here janë edhe në kundërvënie, kjo gjë është si rezultat i saj se përkthyesi arrin që ta ruaj gjuhën orgjinale të veprës. Në shekullin e globalizimit, në shekullin e ndërkombëtarizimit të dijes dhe kulturës, letërsia shqiptare mund të thyejë më tej kufijtë e vetes dhe të mundësojë receptimin në gjuhët e tjera. Kjo kërkon një përgjegjësi sa shtetërore, aq edhe shkencore.

Diskursi rreth veprës „Gjin Bardhela - Etje e gurëzuar” nga këndvështrimi i studiuesve italian

Përkufizimin rreth përkthimit nuk e cilëson aspak të lehtë Umberto Eco. Veprimtaria e të përkthyerit nga një gjuhë në tjetër e një teksti të shkruar ose të folur duket disi tautologjik, sidoqoftë më i qartë nëse kaloj tek lema përkthej:” kthej në gjuhë tjetër, të ndryshme nga ajo e prejardhjes...³⁰ Se si është pritur romani “Gjin Bardhela” të lexuesi, gjegjësisht studiuesit e huaj e që i kanë hap rrugë lexuesit të rëndomët ta kuptojnë më lehtë botën artistike të autorit A Berisha do të shohim në disa nga konkluzionet e mëposhtme. Fillimisht po e citojmë Amik Kasorruho, ku ndër të tjera veçon:

Gjin Bardhela i arbresh pa dyshim flet më shumë për dukuri ndjenja se për ngjarje. Kështu nuk i përgjigjet romanit rrëfënjë, por pa cfiluar asnjë grimë krijimin letrar. Nuk gjejmë në të ndonjë ndodhi që përmbyll një fillim dhe një fund, sepse nuk trajton një copëz jete: është një pasqyrë jete. Shpesh, duke shfletuar faqet e prozës, na bëhet se jemi duke lexuar poezi të mirëfilltë.³¹ Duke e lexuar një vepër orgjinale, këtë rast edhe në brendësinë e saj pavarësisht kohës sa dhe si ka kaluar, mbase mund t’i perceptojmë më afër shumë element strukturore brenda veprës. Po s’i qëndron puna të një lexuesi i huaj, kur thuajse ka fare pak ose aspak informacione mbi atë vepër që është përkthyer në akcilen gjuhë. Sigurisht duhet kuptuar shumë gjëra: në radhë të parë nivelin kulturor mes popujve, pastaj leksiku me të cilën është shkruar vepra, sa e ruan ekujvalencën mes fjalës orgjinale dhe të përkthyer në një gjuhë të dytë. Pastaj çështje kyçe është se në çfarë mase ruhet niveli i fabulës në një roman të përkthyer?

Të respektosh fabulën do të thotë të respektosh referimin e një teksti ndaj botëve të mundshme tregimtare.³² Duke qenë se romani “Gjin Bardhela i arbresh – Etje e gurëzuar” ka të bëjë me një topikë të zhvendosur në tokë të huaj siç është fshati Maqi, njëri nga fshatrat arbëreshe në Itali dhe diferenca tjetër është përfaqësimi i personazheve vjen nga bota shqiptare.

³⁰ Umberto Eco. *Të thuash gati të njëjtën gjë (përvoja përkthimi)*, Dituria, Tiranë, 2006, fq. 27.

³¹ Albana Alia, Labinot Berisha. *Roman vlerash të jashtëzakonshme poetike*, Faik Konica, Prishtinë, 2019, fq. 17.

³² Umberto Eco. *Të thuash gati të njëjtën gjë (përvoja përkthimi)*, Dituria, Tiranë, 2006, fq. 164.

³² Umberto Eco. *Të thuash gati të njëjtën gjë (përvoja përkthimi)*, Dituria, Tiranë, 2006, fq. 164.

Këtu realisht kemi një ekuacion me dy të panjohura tani: Për botën italiane, nëse është vendi i njohur, nuk është e njohur deri në thellësi: tradita kultura dhe legjedat shqiptare. Kurse për botën shqiptare nëse janë të njohur shkaqet e zhvendosjes nga trualli shqiptare të mijëra familjevëshqiptare shekuj më parë, sigurisht se nuk është e njohur pjesa tjetër e jetës së tyre, përtej detit, qoftë në aspektin topik, psikologjik, madje edhe të një ndërtimi të ri kulturor. Ajo që duhet kuptuar është se romani në fjalë, madje i tejkalon veprimet zigzake fizike, madje thënë më qartë sikur personazhet nga një perspektivë tjetër gjenë komoditetin etyre edhe në botën dhe veprimet metafizike. Nuk mund të përjashtohet këtu mendimi i shkrimtarit dhe studiuesit italian Dante Maffia:

Romani “La sete pietrificata” thekson: “Feja e të parëve, e mbrojtur me besime, besëtytëni, mitologji, halucinacione, që të gjitha së bashku krijojnë një kuadër të pasur me nuanca në përqasjen-ballafaqimin jo gjithmonë të krahasueshme mes tyre dhe kështu protagonistii romanit, Gjin Bardhela i Ndre Bua Petës, gjendet pafundësisht në një udhëtim metafizik që hap njëkohësisht porat e ferrit dhe të parajsës...”³³ Po të lexohet me kujdes ky roman, natyrshëm do të duhej të bëjmë një sintezë më të qartë të kodeve poetike. Duke pasur parasysh këtë gjë, mund të konstatojmë se autori me mbrehtësi futet në këto gracka, aspak të lehta, për ta relativizuar me prozën e gjatë. Gjatë gjithë studimeve, analizave mbi këtë roman është folur jo njëherë për praninë e elementeve poetike në roman po si reagon ndaj kësaj çështje studiuesi Dante Maffia:

“Me aftësi të veçantë, Anton Nikë Berisha ndërlihd në kontekstin e romanit, nga njëra anë, legjendat e përrallat, si pjesë traditave të rrënjësura të ngulmimeve arbëreshe, nga ana tjetër, edhe tërsinë e paragjytimeve që shkallë-shkallë janë shndërruar në një mënyrë të ekzistimit e të perceptimit të realitetit. Në këtë këndvështrim romani përfiton kuptime antropologjike të një efikasiteti të rrallë, edhe për faktin që vendos protagonistin në një brendësi të një bote gati magjike, me pasojë që vënë në dukje shkaqe tashmë të rrënjësura e të metamorfozuara në një natyrë të dytë”.³⁴

Në kërkim të vetvetës dhe dhimbjes së shpirtit

Kur flitet për vetvetën dhe dhimbjen shpirtërore, duhet të kuptojmë se kemi diç të zbrazët brenda vetës. Njeriu duke qenë në kërkim të përsosurës, qoftë tek vetvetja, apo në masë, ndodhë që të humb shumë gjëra, madje mund t’i krijohet humbja e lirisë së individit. Të tilla ngjarje kemi shumë qoftë në letërsinë e huaj, por edhe letërsinë shqipe. Por padyshim në shtresa të gjëra përmasore të lexuesit kudo në botë pa dyshim janë dy nga veprat që edhe sot lexohen me shumë dëshirë.

Romani „Ujku i stepave” Herman Heses, tema kryesore në romanin e trajton një njeri që lufton i vetëm dhe rrezikon të thyhet nga vuajtjet e brendshme. Si “Siddhartha”, vepra tjetër e Heses që tregon një histori përrallore të kërkimit religjioz të vetvetes. Deri ku ndiqet kjo simetri në kërkim i vetëvetës- dhembje shpirtërore në romanin e autorit Berisha, duhet shikuar edhe ana tjetër provokuese se si e përjeton këtë ndijim lexuesi, këtë rast edhe i huaj edhe vendas. Domenico Corradin, po ashtu një studiues, filozof e shkrimtar i shquar në këtë vijë reth përfaqësimit të individit në roman do të shprehë: Dhe Gjini është një shtegtar i durueshëm, Odiseu i ri në kërkim të Itakës së vet... Dhe nga hiri i vuajtjes së Gjinit i pavetëdijshmi personal i Berishës, lind përsëri si feniks që tani sjell në dritën rrjetëzimin e dhembjes, tehet e përzjarra, nga të cilat ndihet i shpuar tejpertej...³⁵ se si e sheh në optikën e tij vrojtuese udhëtimin Gjini

³³ Labinot Berisha & Mehmet Gëzhili, *Vepër e pasur dhe e qenësishme, vëll II*, Argeta LMG – Faik Konica, Tiranë- Prishtinë, 2016, fq. 50.

³⁴ Po aty fq. 51.

³⁵ Po aty fq. 52.

Bardhelës, disi të humbur në mjegullnaja të kohës, këtë çështje Sergio Paolo Foresta shpreh kështu: Në ankthin e kërkimit të caktuar të dëshiruar e pastaj të humbur. Deri te thelbi i ndjesive dhe i personave që i qenë të dashur që një farë mënyre edhe u takonte, dhe me një mënyrë i kthen në formën e kujtesës, duke mbetur pjesë e qenies, veçmas në çaste të pezullimit të ekzistencës. Foresta duke iu drejtuar autorit Berisha thekson: “Ti shkruan: ne nuk i takojmë vetvetës, edhe atëherë kur viheminë qendrën e këtij teatri tokësor. Po ashtu është e vërtetë që heshtja është hapi i parë drejt vdekjes.”³⁶

Bota psikologjike e individit në roman

Kur jemi te leximet e një vepre letrare, mbase qasjen e saj, mund ta shqyrtojmë në disa këndvështrime, thënë më qartë, do të ishte e pamjaftueshme, madje deri diku edhe e pambaruar sinteza e një vepre, nëse nuk gërshetojmë me racionalitetin interpretimin psikologjik. Kjo gjë aspak nuk i bënë dëm parametrave të qasjes së veprës, madje veç sa zgjerohet interpretimi tekstual a intertekstual. Duke qenë se peshën e këtij romani e përmban një individ siç është Gjini Bardhela, mund të shtojmë se nuk mund t’i ikim porositë që sinjalizon këtë individ në madhshtinë e tij psikologjike. Sigurisht se nuk duhet nxituar me konstatime të paqartësuar.

Se e shohin këtë çështje në prizmin e instiktivit të individit, ku në këtë rast do t’i shohim si manifestohet relacioni ndaj vetës dhe tjetrit këtë gjë më së miri e shpjegon Frojdi cili i klasifikonte tri komponentët përbërës të aktivitetit mendor të njeriut, Idi, Egoja apo Uni dhe Supergoja apo (Mbiuni). Se si e shohin këto komponente psikologjike, brenda këtij romani po i japim disa nga konstatimet e studiueseve dhe studiuesve italian/e rreth personazhit – individ, Fiorella De Rosa shkruan: Nga brendësia “flet” gjithmonë zëri i rrëfimitarit, ndërsa personazhi “sheh”, ose kupton më mirë këndvështrimin e brendshëm, komplekset dhe rrjedhat e pakapshme të psikikës: në ligjirimin e rrëfimitarit ndërmjetëson monologu i tërthortë i personazhit. Pra kemi të bëjmë me një analizë të hollësishme dhe të gjerë të ndijimeve të brendshme të personazhit, në të cilin procesi psikologjik, qoftë në lëkundjet dhe kthesat e tij, ruan një logjikë të qartë dhe koherente, që ndiqet në mënyrë lineare.³⁷

Ndërsa Giorgio V Sammarra shkruan: “Protagonisti Gjini, në romanin e Anton Nikë Berishës, përmbush në buzë të vdekjes, një lloj excursus personal kthjellues nëpër dredhat e një kujtese individuale e kolektive... Gjini shoqrohet nga dy udhërrëfyes të jashtëzakonshëm, si akretipa danteske të dëshirës, për etje, jo për njohjen, por për afirmimin e kapacitetit të një kulture minoritare për t’u ndërthurur nëpër proceset e zhvillimit dhe të progresit”³⁸

Miti dhe legendat shqiptare në roman nga këndvështrimi i lexuesit të huaj

Në letërsinë artistike shqipe, ndodh që disa nga krijuesit të fusin edhe elementin mitik. Dihet thënë se ndërtimi i këtij elementi në kornizën e një vepre qoftë me elemente reale ose fiktiv, përveç që e do njohjen deri në thellësi për ta krijuar pastaj relacionin mes botës reale dhe fiktive në letërsinë e shkruar. Konsideroj se disa nga krijuesit nuk ia dalin fare, kësaj çështje. Thjesht nuk arrijnë njohjen e kodeve mitike. Ndryshe nga Anton N. Berisha, i cili përveç që e njeh mirë tipologjinë e mitit, legjendës dhe përrallës, ai thjesht përmes këtyre kodeve krijon hapësirë postmoderne letrare.

³⁶ Labinot Berisha & Mehmet Gëzhili, *Vepër e pasur dhe e qenësishme, vëll II*, Argeta LMG – Faik Konica, Tiranë- Prishtinë, fq. 53.

³⁷ Labinot Berisha & Mehmet Gëzhili, *Vepër e pasur dhe e qenësishme, vëll II*, Argeta LMG – Faik Konica, Tiranë- Prishtinë, fq. 224.

³⁸ Po aty, fq. 308.

Këtë kombinatorikë sjell kolazh pamjesh të botëve kundërshtuese, por që referohen një fakti, se në letërsinë që e krijon autori A. N. Berisha “ndjek rrugën për në majën e ajsbergut, brenda pak atij fragmentariteti të lexuesi nuk tenton të hedh gjithçka në sipërfaqe”.³⁹ Është theksuar disa herë se veçanti e këtij romani është ndërtuar përveç kodeve poetike me të cilat vepra në fjalë estetikisht dallohet nga vepra tjera të po këtij zhanri. Si dhe afinteti për futjen e brikolazhit, në këtë rast elementeve mitike dhe legjendave, kryesisht shqiptar. Ne do të ndalemi të çështja e dytë se si e shohin autorët e huaj, respektivisht italian dhe arbëresh, në dritën e këndvështrimeve dhe vrojtimeve të tyre këtë fenomen letrar i cili veç sa e ka pasuruar veprën dhe stilin e ndërtimit të saj. Studiuesi italian Dante Maffia thekson:

Me aftësi të veçanta, Anton Nikë Berisha ndërlidh në kontekstin e romanit, nga njëra anë legjendat e përrallat, si pjesë e traditave të rrënjësura të ngulimeve arbëreshe Disa kapituj janë veçanarisht të rëndësishëm për të kuptuar në thellësi atë që mbetet në veprimet e përditshmërisë (fjala vjen, të shihen në kapitulli tretë me titull “Këmisha e gjarprit”, apo i dymbëdhjetë “Plaka që zhbënte magjitë”), të cilët hedhin dritë për të kuptuar deri në fund atë që mbetet prej të përditshmes dhe atë çka e bën jetën ëndërruese⁴⁰ Ndërsa Vincenzo Bruno për romanin e autorit Berisha ndër të tjera thekson: “Ëndrra që shëndërrohet në mit ose miti që shndërrohet në ëndërr” një rrugë e përshkuar nga populli ynë, siç ndodh edhe me popujt e tjerë...⁴¹

“Një prani tjetër eherëpashershme është ajo e Orëve, ruajtëse të shtëpisë dhe të banorëve të saj: në të njëjtin plan qëndron edhe gjarpri në kapitullin e katërbëdhjetë që, në kthimin e Gjinit... E me raste edhe “për dyshimitë të shtojzovallëve: në raste tjera fiton konotim negativ dhe i referohet vdekjes...”⁴² citon Gianni Antonio Palumbo. Në veprën e Anton Nikë Berishës e hetoj edhe lexuesit e huaj praninë e legjendave shqiptare, të cilat në një farë mënyre edhe kanë përcjell edhe fatin e popullit shqiptarë ndër shekuj. Dy nga legjendat të njohura jo vetëm nga lexuesit shqiptar, por edhe ata të huaj i shfetojmë në disa faqe të këtij romani atë të besës përmes Legjendës (Kreu i VI – kujto legjendën e njohur të Konstadinit dhe Jurediinit). Në kreun VII bëhet fjalë për legjendën e Rozafës ...shkruan Flavia D’Agostino...⁴³

Përfundim

Nga që theskuum deri më tani lidhur eskuzivisht me këtë vepër, duke i përjashtuar mbase edhe disa nga shkrimtar[dhe studdiues, qoftë shqiptarë, por edhe ata italian dhe arbëreshë kryesisht, të cilët për librin kanë folur qoftë nga pasioni për të njohur artin letrar shqiptarë, qoftë ndonjëherë edhe nga miqësia me vet autorin, shkrime të cilët mbase kanë daltë natyrës promocionale dhe pa efekte studimore.

Në fokus të gjithë punimit trajtova ata studiues që letërsinë dhe filozofin e saj e njohin duke sjell rrethana argumentuese, se pse kjo vepër zgjon kërsërinë për të lexuar edhe një lexues i huaj, këtë rast ai italian. Benveniste ka sugjeruar se shprehja, akt komunikues, në të vërtetë është çast i ndërtimit të subjektit në gjuhë.⁴⁴ Duket se autori e ka ruajtur mirë këtë aftësi komunikimi edhe me lexuesin e huaj, duke e parë se ju ka dhënë hapsirë mjaftutueshëm, nga njerëz me kredo për letërsinë.

³⁹ Ag Apolloni, *Brikolazhi narrativ*, Symbol, nr.15, 2018, fq. 65

⁴⁰ Labinot Berisha & Mehmet Gëzhili, *Vepër e pasur dhe e qenësishme, vëll II*, Argeta LMG – Faik Konica, Tiranë- Prishtinë, fq. 183-184.

⁴¹ Po aty fq. 231.

⁴² Po aty fq. 261.

⁴³ Po aty fq. 299-300.

⁴⁴ Linda Hutcheon, *Poetika e Postmodernizmit (Historia-Teoria –Fiksioni)*, OM, Prishtinë, 2013, fq. 121.

Referencat

- [1]. Eco Umberto. *Të thuash gati të njëjtën gjë* (përvoja përkthimi), Dituria, Tiranë, 2006.
- [2]. Berisha Labinot & Gëzhili Mehmet, *Vepër e pasur dhe e qenësishme*, vëll II, Argeta LMG – Faik Konica, Tiranë- Prishtinë, 2016.
- [3]. Apolloni Ag, *Brikolazhi narrativ*, Symbol, nr.15, 2018.
- [4]. Hutcheon Linda, *Poetika e Postmodernizmit*, (Historia-Teoria –Fiksioni), OM, Prishtinë, 2013.